



Viti i XV-të I Botimit, Nr.1,

Qershor 2023

TË JESH MËSUES NË SHQIPËRI - SFIDAT DHE PROBLEMET

Gilberta Hadaj*, Elona Limaj**

Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Përmbledhje

Një edukim cilësor varet nga aftësitë e mësuesve që janë hallka më e rëndësishme e këtij sektori. Edukimi i mësuesve është një proces thelbësor për çdo vend, për shkak të rolit të tyre vendimtar për të ardhmen tonë. Por, të jesh mësues në gjuhën shqipe nuk është e lehtë. Ekziston një mënyrë sfiduese për t'u bërë gati për tregun e punës. Ky udhëtim shoqërohet me fjalë të vështira dhe vite përvojë.

Ky punim do të fokusohet në edukimin e mësuesve dhe hapat që duhen ndjekur për t'u bërë mësues parashkollor fillor dhe të mesëm. Ka disa kriterë që duhen ndjekur dhe procesi është i gjatë. Por edhe pasi bëhet mësues zyrtar, një komponent tjetër është edukimi në vazhdimësi, një përvojë e pafund për një mësues.

Krahas mësimdhënies teorike, praktika profesionale është një hap i rëndësishëm në këtë proces, i cili përbëhet nga një sërë sfidash. Në fund, synohet që mësuesi i diplomuar të ketë të gjitha njohuritë e nevojshme për t'i vënë në dispozicion nxënësve gjatë punës me fëmijët.

Fjalë çelës: *mësues, edukim, sfida, probleme, Shqipëri*

TO BE A TEACHER IN ALBANIA - CHALLENGES AND PROBLEMS

Abstract

A qualitative education depends on the skills of teachers who are the most important chain of this sector. Teachers' education is an essential process for every country, due to their crucial role for our future. But, being a teacher in Albanian is not easy. There is a challenging way to become ready for the labour market. This journey is accompanied by hard word and years of experience.

This work will focus on teachers education and steps to be followed to become an pre-school elementary and high school teacher. There are several criteria to be followed and the process is long. But even after becoming an official teacher, another component is the education in continuity which a never-ending experience for a teacher.

Beside the theoretical teaching, professional practice is an important step in this process, which consists of a series of challenges. At the end, the aim is that the graduated teacher must have all the necessary knowledge to put at disposal of the students during work with children.

Key words: *teacher, education, steps, process, Albania*

Hyrje

“Do ta kryej detyrimin tim me ndërgjegje dhe krenari. Nxënësit e mi nuk do të jenë vetëm nxënës, por edhe fëmijë dhe kurrë nuk do t’i harroj që për fatin e tyre edhe vetë mbajë një pjesë të përgjegjësisë. Do ta mbrojë me të gjitha mjetet ekzistuese nderin e profesionit të arsimitarit. Kolegët e mi çdo herë do të jenë edhe miqtë e mi. Në bashkëpunim me ta do të përpiqem që vazhdimisht ta përkryej veprimtarinë e shkollës në kuptimin efikas të njohjes së të gjithave të drejtave në edukimin dhe barazinë sociale në arsim. Këtë betim solemn e jap plotësisht në mënyrë të lirë dhe me nderë .”

(Betimi i Hipokratit,të cilin në vitin 1966 për nevojat e UNESCO-s e përpiloi pedagogu zviceran,
Robert Dottrens 1893 – 1984)

Mësimdhënia është një proces dinamik dhe diktohet gjithnjë nga zhvillimet dhe kërkesat në rritje e ndryshim ndaj brezave të reja. Diversiteti pikëpamjeve, llojshmëria e përvojave dhe krijimtaria e pamatë e mësuesve, janë faktorë të tjerë që ndikojnë në dinamizmin e mësimdhënies.

Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi e shprehi të shumta. Një nga detyrat më të vështira në edukim, është përcaktimi dhe përshkrimi i karakteristikave të mësuesit të suksesshëm.

Mësimdhënia, në kuptimin e ngushtë është akti i dhënies së mësim në një institucion arsimor. Proces i mësimdhënies është një nga faktorët më të rëndësishëm dhe më ndikues në realizimin e qëllimeve të nxënies. Mësimdhënia i ndihmon nxënësit të nxënë. Nisur nga kjo, disa e cilësojnë mësimdhënien si një proces, si një veprim ose si një veprimtari ndërpersonale, ku mësuesi bashkëvepron me një ose më shumë nxënës dhe ndikon tek ata, por që nënkupton edhe ndikimin e nxënësve te mësuesi.

Çfarë është mësuesi?

Mësuesi është njeriu që ka për detyrë të ndihmojë të tjerët të mësojnë dhe të sillen në një mënyrë të re dhe të ndryshme nga më parë. Megjithatë, në zakonisht e përdorim termin mësues për ata njerëz, detyra kryesore, funksionale, apo profesionale e të cilëve është t’i mësojnë të tjerët të mësojnë dhe të përvetësojnë shprehi e mënyra të reja të sjelljes. Arsimimi, të nxënësit dhe mësimdhënia ndodhin në mjedise të ndryshme dhe pjesa dërrmuese e shoqërive e kanë të qartë se arsimimi është shumë i rëndësishëm, prandaj, nuk mund t’i lihet rastësisë. Për rrjedhojë shoqëritë ngrenë shkolla për ta lehtësuar të nxënësit dhe për t’i ndihmuar njerëzit që të bëjnë një jetë më të mirë. Shkollat hapen për të dhënë një lloj përvojë arsimore, mbi bazën e synimeve të qarta dhe të një plani të caktuar, i ciliprogram dhe në kuptimin më të gjerë e që përdoret sot, kurrikul.

Mësuesit përgatiten dhe punësohen nga shoqëria për të ndihmuar në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të programit. Mësuesi në procesin e përgatitjes së tij arsimore, është një punonjës i punësuar nga shoqëria, për ta bërë më të lehtë përgatitjen shoqërore, vetjake dhe intelektuale të atyre anëtarëve të shoqërisë të cilët ndjekin shkollën.

Deri disa dhjetëvjeçarë më parë, mësuesit nuk kishin ndonjë përgatitje të madhe arsimore dhe, shpeshherë, ata nuk dinin më tepër se nxënësit e tyre. Sot mësuesit janë më të arsimuar, trajtohen më mirë, dhe respektohen më shumë nga shoqëria, në krahasim me homologët e tyre të shekujve të mëparshëm. Shoqëria kërkon që mësuesit e saj të kenë arsim universitar dhe një përgatitje të veçantë si mësimdhënës. Kjo rritje në nivel arsimor të mësuesve bazohet në faktin se, në qoftë se mësuesi duhet që ta lehtësojë formimin shoqëror, vetjak dhe intelektual të nxënësve të tij, kuptohet që ai duhet të jetë shumë më tepër i arsimuar, në krahasim me të kaluarën.

Si të bëhesh një mësues në Shqipëri?

Të bëhesh mësues i ciklit parashkollor, fillor apo atij të mesëm tashmë duhet të ndiqen një sërë hapash. Në ligjin e arsimit të lartë apo atë parauniversitar janë të përcaktuara qartë kohëzgjatja, rruga apo mënyra që duhet të ndjekë një student për të ushtruar profesionin e mësuesit në Shqipëri.

Arsimi fillor.

Mësuesia duhet të organizohet në dy cikle. Cikli i parë ai i diplomës Bachelor, me 3 vite dhe 180 kredite të ndjekura nga studimet e Ciklit të Dytë me 1-2 vite me 60-120 kredite (Master Profesional; Master i Shkencave). “Mësuesit e arsimit parashkollor dhe atij fillor duhet të formohen nga studime bachelor 3 vjeçare me 180 kredite me kurrikul të ndërtuar për këtë cikël. Pas këtyre studimeve studentët mund të kalojnë në tregun e punës si mësues ndihmës pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licencimit)” Sipas këtij të fundit, një tjetër mundësi për këta studentë është vazhdimi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional 60 kredite 1 vjeçar, i cili duhet të jetë i diferencuar në MP, që përgatit mësues për arsimin fillor. Pas fitimit të diplomës së Ciklit të Dytë të diplomuarit sipas titullit përkatës të diplomës mund të kalojnë në tregun e punës si mësues pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit, pas provimit të licencimit.

Arsimi i mesëm

Për të qenë mësues në arsimin e mesëm duhet të plotësohen një sërë kushtesh të tjera. Kështu ndryshme nga arsimtarët në ciklin e ulët, ata të arsimit të mesëm duhet që studimet e ciklit të dytë t’i kenë në master të shkencave dhe ky të jetë dy vjeçar. “Mësuesit e Arsimit të mesëm të kenë përfunduar ciklin e parë të studimeve dhe të ndjekin ciklin e dytë të Master i Shkencave 2 vjeçar 120 kredite, i cili përgatit mësues për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë”. kurrikulat e Programeve të studimit të Ciklit të Dytë për përgatitjen e mësuesve duhet të ruajnë një ngjashmëri në nivel kombëtar sipas fushës së shkencës përkatëse 80% në ndërtimin e tyre.

Po kështu, pas diplomimit të studentëve me diplomën e ciklit të dytë, duhet të zhvillohet praktika profesionale, pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Ndërkohë një tjetër pikë e rëndësishme është edhe ajo e edukimit në vazhdim. Nga legjislacioni në fuqi kërkohet që formimi i mësuesve duhet të jetë i vazhduar, universitetet duhet të krijojnë kushte për trajnimin dhe formimin e vazhduar të mësuesve në bashkëpunim me institucionet shtetërore të Arsimit të Mesëm.


Mësues nga fusha të tjera.

Në kuadër të formimit të vazhduar, profesioni i mësuesit në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diploma të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, si edhe të zotërojnë certifikata për formimin psiko-pedagogjik të lëshuara nga IAL që ofrojnë këtë program studimi.

Analizë

Nisur nga sfidat dhe problematikat që mund të ketë një mësues në Shqipëri u realizuar një pyetësor i shkurtër për 100 mësues në zonat urbane dhe rurale të qytetit të Tiranës. Ky pyetësor u ndërtua mbi bazën e disa pyetjeve për të kuptuar më mirë se sa e njohin legjislacionin e sistemit arsimor mësuesit, a realizojnë ata trajnime për të trajtuar risitë në arsim, sa të informuar janë për arsimin gjithëpërfshirës si një nga problematikat në vendin tonë. Të gjitha këto të dhëna janë të përmbledhuara në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Nr.	Pyetja	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë
1	Sa trajnime zhvilloni gjatë vitit shkollor?	15	5	10	20	50
2	Sa njiheni ju me udhëzimet e reja në sistemin arsimor?	5	5	23	47	20
3	A keni ju problematika në arsimin gjithëpërfshirës?	49	22	13	9	7
4	A është kohë e gjatë studimi për tu bërë një mësues në Shqipëri?	85	12	3	0	0
5	A marin problemet Tuaja zgjidhje nga titullarët e institucioneve?	34	52	4	6	4
6	Sa angazhoheni ju për tu njohur me ligjislacionin për arsimin?	19	26	31	17	7



Përfundime

Në bazë të të dhënave të pyetësorëve të realizuar u arrit në disa përfundime:

- Shumë prej mësuesve të anketuar nuk e njohin legjislacionin e sistemit arsimor në vendin tonë. Njohuritë për ligjet, udhëzimet apo vendime të ndryshme që prekin sistemin arsimor nuk njihen nga mësuesit ose njihen shumë pak.

- Profesionit i mësuesit kërkon një kohëzgjatje të madhe deri në daljen në tregun e punës. Për këtë shkak numri i të diplomuarve për mësuesi sa vjen dhe ulet.
- Mësuesit kanë ende mungesë informacioni në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës, ata përpiqen të marrin informacione nëpërmjet internetit, ndarjes informale të përvojave dhe mjeteve të tjera informale; për shumë prej tyre arsimit gjithëpërfshirës nuk ka qenë madje as kurs në studimet e tyre universitare;
- Trajnimet ose kualifikimet e tjera që lidhen me arsimin, njohjen e legjislacionit apo arsimin gjithëpërfshirës kanë qenë shumë të pakta. Më shumë mësues të kualifikuar dhe të trajnuar ishin më pozitivë dhe optimistë në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri, një tregues që bën thirrje për kualifikime të mëtejshme të mësuesve në këtë çështje;
- Mësuesit e zonave rurale përballen me më shumë sfida në lidhje me shumë problematika në arsimin gjithëpërfshirës: ekspertët psikosocialë nuk shkojnë në këto shkolla, fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi që të vendosen në një klasë të përshtatshme, prindërit janë të pa informuar.

Referenca

1. Musai, Bardhyl (2014) Metodologji e Mësimdhënies, Qendra për Arsim Demokratik
2. Boris, Gary D. (2000) Effective Teaching Methods, 4th ed, Pearson
3. Document of Strategy for Development of Pre-university Education (2014-2020) drafted by Ministry of Education and Science
4. Scrivener, James (2011) Learning Teaching, 3rd Edition, Macmillan Publishings,
5. Ligji Nr. 69/2012 “Për arsimin universitar në sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë”
6. Deloitte and IPSOS, Sharing Europe’s digital future (2019) 2nd Survey of Schools: ICT in Education, European Commission
7. Woolfolk, Anita (2011) Psikologji edukimi, Tirana, CDE
8. Bandura A. (1997) Social learning theory, Englewood. Cliffs Nj; Prentice Hall
9. Mayer R.E. (2008) Learning and instruction (2nd.ed) Columbus OH, Merrill/Prentice Hall
10. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021-2026, hartuar Ministria e Arsimit me mbështetjen e UNICEF
11. Ligji i arsimit të lartë 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë Në Republikën e Shqipërisë”
12. Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

